



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 945

Datë: 10.06.2019

PROCESVERBAL

i mbledhjes së V-të (pestë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II- (dytë) 2019.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/159 datë:12.02.2019, për miratimin e aneks-Planit Komunal të veprimit për Eficiencë të energjisë (PKVEE) 2019-2021.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/203 datë:28.03.2019 të parashtruar nga Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për Barazi Gjinore të parashtruar nga kryesuesja e Komitetit për Barazi Gjinore zj.Hidajete Mazreku.
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale për vitin 2018.
6. Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2019.
7. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/604 datë:13.05.2019 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për iniciimin e procedurave të mëtejme sipas kërkesës për këmbimin e sipërfaqes së paluajtshmërive me paluajtshmëri, sipas kërkesës nr.06/05 datë:23.01.2019.
8. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/592 datë:13.05.2019 për caktimin e pikës së grumbullimit, transportit dhe depozitimit të mbeturinave jo të ngurta, përkatësisht caktimit të pikës së transferit të mbeturinave në territorin e Komunës së Malishevës.
9. Shqyrtim i Raportit të detajuar të punës së zyrës së Tatimit në pronë për vitin 2018.
10. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndërtim të shtëpive për familjet e pa strehë.

11. Emërimi i anëtarëve të Komisionit për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/526 datë:25.04.2019 , për marrjen e vendimit për procedurë të mëtejme për caktimin e lokacionit për “Ndërtimin e Pishinës Gjysmë Olimpike” në Komunën e Malishevës.
13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1597 datë:06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc, KK.Malishevë.
14. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/88 datë:07.02.2019 për ndarjen e zyrave për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës-Dega në Malishevë dhe Shoqatën e Pensionistëve në Komunën e Malishevës, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-146/3 datë: 06.03.2019, si dhe marrja e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës publike.
15. Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të Komunës nr.01/458 datë:15.04.2019, sipas shkresës së KPF-së nr.02/197 datë:26.03.2019.
16. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/482 datë:18.04.2019, për iniciimin e procedurave sipas kërkesës për kompensim nr.01/452 datë: 15.04.2019 parashtruar nga z.Gani R.Mazreku nga Malisheva.
17. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/192 datë:22.03.2019 të parashtruar nga Kryetari i fshatit Novosellë.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/29 datë:15.03.2019 të parashtruar nga z.Mujedin Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/27 datë:18.03.2019 të parashtruar nga z.Hazir Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/28 datë:18.03.2019 të parashtruar nga z.Alban Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
21. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/33 datë:21.03.2019 të parashtruar nga z.Qamil Vesel Hoti nga fshati Carrallukë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
22. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/38 datë:27.03.2019 të parashtruar nga z.Bahti Thaçi nga fshati Mirushë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
23. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 22.05.2019 dhe filloi në ora 10:39 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 17 asambleistë, Nënkryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI, LMT dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë ju të pranishëm! Po e hapi mbledhjen e V-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës. Si gjithëherë fillojmë me debatin jashtë rendit të ditës, urdhëroni kush e do fjalën?

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Dje kishte një protestë në fshatin Llozicë për shkak të neglizhencës së qeverisë lokale dhe ajo qendrore për kyçjen në autostradë. Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit me 10 prill Kuvendi ka marrë një vendim për kërkesat e fshatit Llozicë, Vërmicë dhe Drenoc që këto kërkesa t'ju adresohen Ekzekutivit që ata të inicojnë çështjen në nivelin qendror mbrenda 1 muaji. Nënkryetar, a keni marrë ndonjë masë lidhur me këtë çështje dhe a po e zbatoni vendimin e Kuvendit?

Po flas në emër të Komitetit për Familje të Dëshmorëve dhe Kategori të dalura nga lufta. Ky Komitet në vitin e kaluar ka bërë një kërkesë për ndarjen e një parcele 5 ari për ndërtimin e zyreve për organizatat e dalura nga lufta. Ne si komitet nuk kemi marrur asnjë përgjigje për këtë kërkesë. Ne kemi bërë edhe kërkesa e dytë me datë 11.02. 2019 dhe përsëri nuk kemi marrur përgjigje. Ne duam përgjigje për këtë kërkesë.

Ali Morina: Pershendetje për të gjithë! Shqetësim i imi është trafostacioni që gjendet mbrapa Muzeut. Nënkryetar, pas takimit që keni pasur me strukturat udhëheqëse të KEDS-it dhe a keni ngritur çështje e trafostacionit mbrapa Muzeut ku grumbullohet uji i cili paraqet rrezik për qytetarët që kalojnë andej. para se të ndodh ndonjë incident është mirë që t'i obligoni institucionet përkatëse që të marrin masa për këtë çështje.

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Në fshatin tim, në vendin e quajtur Llukshiq është krijuar një deponi e madhe e bërllogut e cila është afër shkollës, prandaj kërkoj që të bëhet diçka nga drejtoria përkatëse për këtë deponi të bërllogut që nga paslufta e këndej. Çështja e dytë ka të bëjë me fshatin Mleqan i cili ka mbetur shumë keq për kyçjen që shkon për Prishtinë për shkak të autostradës që t'i punojnë arat e veta atyre ju duhen 9 km rrugë t'i bëjnë. Kërkoj në emër të atyre banorëve që të bëhen kërkesa të vazhdueshme në Ministrinë e Infrastrukturës që t'ju lejohet një qasje në pronat e tyre matanë rrugës.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Mbase Kryetari nuk është këtu kam një pyetje për Nënkryetarin. Lagjia "Hysenaj" e ka bërë një kërkesë për rrugën "Gjergj Kastrioti-Skenderbeu" që shkon për Banjë për vendosjen e disa ndërpresave për shkak të rrezikshmërisë dhe shpejtësisë së madhe në rrugë. Aty rrezikohen fëmijët dhe çdo këmbësor që kalon aty pari. Është mirë që nga ana e Kryetarit të merret aty ndonjë veprim për këtë çështje.

Disa qytetarë të Dragobilit kanë bërë disa investime në fshat në mënyrë vullnetare por a janë konsultuar ata me Drejtorinë e Urbanizimit apo me Inspektoriatin për ato investime sepse ka ankesa nga disa qytetarë se diku e diku po ju pengojnë qasjen në shtëpinë e tyre.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Meqenëse jemi në debatin jashtë rendit të ditës unë po ua uroj shpalljen kampion të Ligës së Dytë Klubit të Futbollit “Ujëvara” në Malishevë. Pra Malisheva për herë të parë po hynë në historinë e futbollit të Ligës së Parë në Futboll të Kosovës. Këtij klubi i uroj suksese të mëtutjeshme dhe ju ftoj të gjithë juve që ta ndihmojmë klubin në në çdo formë për korrur suksese.

Raimonda Krasniqi: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Lidhur me përfituesit e shoqatave joqevitare dhe personave fizikë të cilët kanë aplikuar për përkrahjen nga Komuna e Malishevës për vitin 2019. Me datë 13.02.2019 Kryetari i Komunës jep njoftimin Thirrje Publike për aplikim, ku kanë pasur të drejtë të aplikojnë OJQ dhe persona fizikë për përkrahje finaciare në bazë të kriterëve që përcakton ligji për Vetëqeverisjen Komunale. Me datë 19.04.2019 nga Kryetari i Komunës nxjerret vendimi ku publikohen emrat e përfituesëve të OJQ dhe persona fizikë që kanë aplikuar. Vendimi paraqet shpërdorim të pozitës zyrtare të Kryetarit dhe abuzim me paranë publike që ju përkasin qytetarëve tanë. e para, në vendim vula është mbrapshtë me kokë poshtë. Nuk figurojnë projektet me të cilat kanë konkuruar OJQ-të dhe personat fizikë për të verifikuar se a është bërë përzgjedhja e duhur dhe a kanë përfituar personat që e meritojnë. Mundojnë në vendim OJQ-të dhe personat fizikë me numër 6-të, 12-të, 18-të dhe nuk dihet pse nuk figurojnë në këtë vendim. Për OJQ me nr. 2 në vendim klubi i futbollit “Malisheva” Kryetari merr akvendim që me datë 01.04.2019 t’i ndajnë këtij klubi shumën në vlerë 500€. Me datë 15.04.2019 i ndahet shuma prej 1,000€ dhe me vendimin e datës 19.04.2019 të përkrahet finaciarisht si OJQ me shumë 22,000€. Brenda muajti të 4-ërt për vitin 2019 janë lejuar për klubin e futbollit të Malishevës me vendim të Kryetarit 23,500€ gjithësej. Ne nuk jemi kundër mbështetjes së sportit por me gjithë këto para kemi mundur të blejmë vendin në ligën e parë. Stadiumit “Liman Gegaj” vetëm me furnizim me gomë të grimcuar me 15.04.2019 i ndahet shuma prej 9,500€. Përfituesi me numër 4 Prespektiva për Rini dhe Intergrim Social e cila është në Prishtinë ka përfituar shumë 500€. OJQ “Çeliku” me nr. 5 që ka për bashkëthemeluese drejtoreshën e Kulturës Besa Ramaj ka përfituar shumën 1,000€. OJQ me nr. 7 “Qendra e Rinisë në Malishevë” ka përfituar shumën 1,000€ kryetar i saj është Amrush Helshani dhe ka qenë anëtar komisioni dhe ka nënshkruar dhe i ka ndarë vetës këtë shumë. Përfituesi me nr. 8 SHPSSH Malishevë nuk dihet se çfarë është por ka përfituar shumën 500€. Përfituesi me nr. 25 që funksion në Prishtinë ka përfituar shumën 500€.

Kam disa pyetje për Nënkryetarin. Sa ka qenë numri i personave fizikë dhe i OJQ të cilët kanë aplikuar? A është komisioni që ka bërë përzgjedhjen nga ekspertë që e njohin rëndësinë e secilës OJQ që vepron në Malishevë? A ka dorëzuar secila OJQ dhe person fizik projekte dhe a i keni ju projektet e tyre? Pse mungoj në vendim emrat e OJQ dhe personave fizik me nr. 6, 12 dhe 18? A keni arsyetim pse këto OJQ nuk kanë përfituar? Pse kanë përfituar 2 OJQ që nuk janë të Malishevës? A përbënë shkelje të ligjit dhe shpërdorim të detyrës ndarja e shumës në vlerë 1,000€ OJQ me nr. 7? A keni arsyetim për të shpjeguar shumën e parave në vlerë 23,500€ vetëm muajit të 4-ërt për klubin e futbollit “Malisheva”? A është e madhe shuma prej 9,500€ vetëm për material gomë të grimcuar për stadiumin “Liman Gegaj”?

Nebih Bibaj: Pershendetje për të gjithë! Kam disa shqetësime të cilat do t'i paraqesë këtu. Në vitin 2018 në buxhet kanë qenë të planifikuara 60,000€ për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, mirë po nëpër rrugë ka gropa, prerje të tyre dhe nuk janë renovuar. Nënkryetar a duhet të krijohet nodnjë standard që ato rrugë që prehen gjat punimeve të kthhen në gjendjen e mëparshme? Në Lladroc çdo 300m asfalti është i këputur dhe askush nuk e jep asnjë përgjegjësi.

Ne si fshat i kemi bërë kërkesë Kryetarit për ndërrimin e pomave të ujit sepse ato të cilat janë aty nuk kanë kapacitet për sjelljen e ujit në bazen. Prandaj kërkoj që ju në koordinim me Hidroregionin që t'i ndërroni ato pompa sepse fshati është pa ujë.

Shqetësmimi tjetër është për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave sepse ata paraprakë nuk i keni pyetur asgjë por me militantë të juaj apo kryetart e nëndegëve jeni konsultuar për projekte dhe nuk e keni ndjekur vijën institucionale apo kryetarin e fshatit.

Behije Sertolli: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Po ashtu edhe unë si Avdiu ju uroj fitoren shkollës "Ismail Qemali" në garat e volejbollit në kuadër të Republikës! Në disa raste disa klube po i ndihmoni por disa klube po korrin suksese me kapacitetet e veta që kanë.

Kam një pyetje për Nënkryetarin që ka të bëjë me noterin sepse ka 3-4 muaj që s'ka noter në Malishevë. Ku qëndron arsyeja që nuk është hapur me kohë konkursi për noter? Duke r marrur prasysh numrin e banorëve në Malishevë duhet të ketë 3 noterë.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Edhe unë ju uroj fitoren klubit të futbollit në Malishevë dhe gjithë atyre që e kanë përkrahur! Mirë që në debatin para rendit të distës po diskutojmë për fitore duke ju uruar edhe fitoren e volejbollit të klubit nga Bellanica dhe këto dy fitore janë rezultate të Malishevës të cilave ne i gëzohemi.

Çështja tjetër për të cilën dua të flasë për nënkalinimin që lidh fshatrat Mleqan, Balincë dhe Llozicë në autostradë. E di që Nisma si subjekt politikë ka bërë presion pozitiv që kjo çështje të përfundojë sa më shpejtë dhe ne për së afërmi i kemi dëgjuar kërkesat e këtyre qytetarëve dhe konsideroj që kjo është një çështje e përfunduar.

Kryesues, meqë kemi një material voluminoz do të kërkoja sa më shpejtë të hymë në rendin e ditës.

Sadije Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Shqetësim për qytetarët tanë është gjendja jo e mirë e kanalizimeve në fshatin Drenoc si dhe në Malishevë afër Ben-af ku është një situatë jashtëzakonisht e keqe dhe si rezultat i kësaj po dëmtohen edhe pronat e qytetarëve. Kërkoj nga drejtoritë përkatëse që të sanohet ajo gjendje e të mos kemi probleme të tilla.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Po ndërlidhem për çështjen e noterisë dhe është ligji ku specifikohet çështja e numrit të noterëve karshi numrit të banorëve të një komune dhe kjo çështje është kompetencë e nivelit qendror, përkatësisht Ministria e Drejtësisë.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Në emër të LDK-së klubit të futbollit “Malisheva” ju uroj fitoren dhe hyrjen në Ligën e Parë si dhe i uroj nxënësit e shkollës së Bellanicës shpalljen për herë të 4-ërt kampionë në volejboll!

Hajdin Berisha: Pershendetje për të gjithë! Duke hyrë në vazhden e urimeve unë ju uroj nxënës të Kërvasarisë shpalljen kampionë në futboll, nxënës të Bellanicës në volejboll dhe klubi i Atletikës ka fituar Kupën e Kosovës për grupmoshat U14 dhe U16 dhe krejt në fund i uroj klubit të futbollit fitoren dhe hyrjen në Ligën e Parë duke shpresuar që ë korrim fitore e të hymë në Superligë!

Ilaz, kemi qenë në rrjedha sa i përket protestës së qytetarëve në Llozicë dhe Kryetari paraprakisht ka biseduar me qytetarët dhe ka përcjellur kërkesat në Ministri. Dje zv. Ministri në Ministrinë e Infrastrukturës ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka dhënë premtimet që shumë shpejt kjo çështje do të zgjidhet.

Sa i përket ndarjes së loakacionet për shoqatat e dalura nga lufta ne i mbështesim këto kërkesa dhe këto shoqiata dhe janë më mirë se në vendet tjera sa u përket zyreve.

Ali, në vitin e kaluar vetë kam intervenuar sa i përket grumbullimit të ujit te trafostacioni afer Muzeut dhe rryma nuk ndalet si rezultat i grumbullimit të ujit, mirëpo ne do të kemi mbikëqyrje përsëri.

Sylë, problemi me mbeturinat inerte është i pashmangëshëm dhe është një pikë e rendit të ditës sot dhe është mirë që t'i japim kahje kësaj çështje.

Alban, është shqetësim edhe për ne çështjen që ngrite. Ne kemi kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit që t'i vendos shenjat spese aty duhet të vendosen ato pengesa pavarisht që nuk është kompetencë e komunës por është në pyetje jeta dhe siguria e qytetarëve.

Rinia e Dreagobilit e di që është duke punuar me një entuziazëm të mirë dhe nuk kemi pasur asnjë ankesë që ka ardhur nga qytetarët, por nëse pengohet ndonjë rrugë sigurisht që intervenojmë.

Raimonda ka një seeri të pyetjeve të cilave do të duhej ndoshta që edhe në seanca tjera t'u përgjigjim, por është viti i dytë që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport po e zbaton një udhëzim administrativ sa i përket subvencionimit të OJQ-ve dhe e konsiderojmë që ato që e kanë fituar e meritojnë këtë subvencionim. Sa i përket kompletimit të dokumenteve nëse ka dyshime që ndonjë dokument mungon, lëndët janë të gjitha dhe secili mund të ketë qasje, por me 23,000€ nuk blehet asgjë dhe klubi këto fitore i ka fituar me ndjersë.

Çështja e gomës për stadiumin nuk ka të bëjë me këtë shumë 23,000€ sepse stadiumi në vazhdimësi duhet të furnizohet me gomë dhe procedurat kanë qenë krejt ndryshe nga ajo subvencionuese.

Behije, nuk është kompetencë e komunës që të shpallë konkurs për çështjen e noterisë. Luani i përmendi procedurat cialt janë në bazë të ligjit.

Po Sadije ne do të bëjmë më shumë përpjekje për mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e knalizimeve dhe të rrugëve dhe do të shohim se sa kemi mundësi që të bëjmë në këtë drejtim.

Rrahim Morina: Kërkoj që përgjigjet t'imerri me shkrim për ato që nuk u dhanë sot këtu, gjithashtu është mirë që edhe shqetsimet dhe kërkesat e juaja në drejtim të ekzekutivit ju asambleistë t'i bëni me shkrim.

Kalojmë në debatin për rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë. I kam 4 kërkesa të mija që të futen në rendin e ditës:

1. Formimi i Këshillit Organizativ për Manifestimin e Ditës së Çlirimit të Malishevës
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/302, dt: 21.05.2019 e parashtruar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimin e Rrugëve si dhe Emërtime të reja. Materialin e keni të shpërndarë nëpër tavolina.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/300 dt: 21.05.2019 e parashtruar nga Alban Krasniqi, anëtar i Kuvendit për zëvendsimin të anëtarit të Komisionit për Organizimin e Javës së Diasporës dhe Ndarjen e Mirënjohjeve
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/290 dt: 14.05.2019 e parashtruar nga Hidajete Mazreku Kryesuese e Komitetit për Komunitete për zëvendsimin e anëtarit të Komitetit

Këto janë 4-kërkesat dhe për të gjitha materialin e keni dhe kërkoj që të futen në rendin e ditës. E hapi debatin për rendin e ditës.

Ilaz Krasniqi: Propozim i 3 grupeve opozitare PDK-së, LDK-së dhe VV-jes është që të largohen nga rendi i ditës pikat 7, 8, 12, 13, 15 dhe 16 të cilat nuk kanë kaluar përmes KPF-së sepse janë të rëndësishme së veçantë dhe kanë të bëjnë me pronën publike dhe është dashur të kalojnë nëpër KPF, e pastaj të vijnë këtu.

Kërkojmë gjithashtu që pikat e propozuara nga Kryesuesi të futen në rendin e ditës.

Luan Kryeziu: Këtë herë po të përgëzoj për thirrjen e mbledhjes që e ke bërë mbrenda afatit ligjor, Kryesues!

Bëjë thirrje që kërkesat e kërkesat e Kryetarit të mos hiqen nga rendi i ditës sepse ato duhet të shqyrtohen dhe të trajtohen në Asamble, ndërsa a kalojnë a jo me votë është diçka tjetër. Kryesues pikat që dëshironi t'i hiqni më mirë mos i bjerni me rend të ditës.

Nebih Bibaj: Ne PDK-ja e mbështesim propozimin e Ilazit për largimin atyre pikave dhe për futjen e propozimeve nga Kryesuesi në rend dite.

Alban Mazreku: Kryesues për këmbimin e pronës në vitin e kaluar ne si Asamble e kemi marrur një vendim që e kemi obliguar Kryetarin që të paraqes projektin para Asamblesë Komunale por edhe para gjithë atyre pronarëve që kanë pasur të kompenzohen. Realisht ky vendim është shkel nga ana e Kryetarit sepse nuk është prezantuar projekti.

Neva na ka ardhur një lëndë tjetër nga Nazif Gashi nga fshati Vërmicë ndërsa këtu i është lëshuar një vendim për rrënimin e objektit në fshatin Vërmicë. Neve si asambleistë po na qesin në lajthitje ekzekutivi sepse ne duhet ta ndryshojmë këtë vendim paraprakisht për këmbimin e pronës.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim. Është një propozim nga Ilaz Krasniqi i mbështetur nga PDK-ja, LDK-ja dhe VV-ja që të hiqen nga rendi i ditës pikat: 7, 8, 12, 13, 15 dhe 16 të cilat nuk kanë kaluar përmes KPF-së dhe të futen në rendin e ditës pikat që unë i propozova. Kush është pro këtij propozimi?

Për: 17

Kundër: 6

Abstenim: 0

Me këtë votim aprovohet propozimi i Ilazit i mbështetur nga PDK-ja dhe LDK-ja.

Jemi në votim për rendin e ditës. Kush është për që të aprovohet rendi i ditës me ndryshime dhe plotësime?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 6

Me këtë votim aprovohet rendi i ditës.

Propozoj që pas pikës e 2-të të renditen pikat që i propozova unë sepse kanë vetëm votim dhe janë procedura të thjeshta. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me këtë votim bëhet renditja ashtu siç propozova unë.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -II- (dytë) 2019. E hapi debatin për këtë pikë.

Nebih Bibaj: Po e sqaroj pak se unë kam folur për një gropë septike që është mbi Banjë jo në rrugë.

Rrahim Morina: Atëherë kush është pro aprovimit të procesverbalit?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me këtë votim aprovohet procesverbali i mbledhjes së II-të të rregulltë për vitin 2019.

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/159 datë:12.02.2019, për miratimin e aneks-Planit Komunal të veprimit për Eficiencë të energjisë (PKVEE) 2019-2021. Fjalën e ka Çlirimi.

Çlirim Karaqica: Pershendetje për të gjithë! Dua t'ju prezantoj Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë që është në kuadër të Planit për Energji Eficiente. Ky plan përfshihet prej vitit 2019-2021. Ky plan i parasheh objektet administrative, objektet kulturo-sportive, objektet e mjeksisë familjare. Projektet që kanë më së shumti energji janë paraparë 5. Ato projekte janë dy

objektet komunale, QKMF-ja, shkolla fillore “Vesel Pagarusha” në Pagarushë si dhe gjimnazi “Hamdi Berisha” në Malishevë.

Kërkoj mirëkuptimin e juaj për këtë plan dhe ta votoni sepse duhet të precizohet në Ministri e pastaj të aplikojmë për finacim në Fondin për Energji Efiçiente.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë. Mbase s’ka diskutues. Kuëhs është pro aprovimit të Aneks-Planit Komunal të Veprimit për Efiçiençë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021?

Për: 20 (unanimisht)

Me votim unanim aprovohet Aneks-Planit Komunal të Veprimit për Efiçiençë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Formimi i Këshillit Organizativ për Manifestimin e Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve në Malishevë. E dini që çdo herë e kemi ndjekur një formulë që pjesë e këtij Këshilli të jetë Kryetarit, Kryesuesi, nga një përfaqësues i subjekteve politike dhe 1 përfaqësues nga shoqatat e dalura nga lufta që gjithësej bëjnë 7. Kush është pro formimit të këtij Këshilli me këtë përbërje?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim formohet Këshilli Organizativ për Manifestimin e Ditës së Çlirimit të Malishevës.

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rednit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/302, dt: 21.05.2019 e parashtruar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Emërtimin e Rrugëve si dhe Emërtime të reja. Materialin e keni të shpërndarë nëpër tavolina.

Çështja është për një zyrtaren Valdete Morina që të jetë pjesë e Komisionit por pa të drejtë vote që si eksperte profesionale do ta ndihmojë këtë komision. Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me këtë votim Valdete Morina bëhet antare e këtij komisioni.

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/ 300 dt: 21.05.2019 e parashtruar nga Alban Krasniqi, anëtar i Kuvendit për zëvendsimin të anëtarit të Komisionit për Organizimin e Javës së Diasporës dhe Ndarjen e Mirënjohjeve. Çështja është që Albani ka ofruar dorëheqje nga ky komision dhe në vend të tij është propozuar Hidajete Mazreku. Kush është për këtë ndryshim?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 9

Me këtë votim Hidajete Mazreku bëhet anëtare e Komisionit për Organizimin e Javës së Diasporës dhe Ndarjen e Mirënjohjeve.

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/290 dt: 14.05.2019 e parashtruar nga Hidajete Mazreku Kryesuese e Komitetit për Komunitete për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete të Artur Osmanit që në vend të tij është i propozuar Muharrem Islamaj. Kush është për?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 9

Me këtë votim Muharrem Islamaj bëhet anëtar i Komitetit për Komunitete.

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/203 datë:28.03.2019 të parashtruar nga Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. E hapi debatin për këtë pikë.

Nebih Bibaj: Jam anëtar i këtij Komisioni dhe në të njëjtën kohë po ju jap disa sqarime dhe një pjesë të punës që nuk po e bënë Inspektoriati për këta billbordat.

Ne kemi ardhur në përfundim në Komision që kjo çështje të kthehet edhe njëherë në Kuvend për shkak që ne i kemi 280m² dhe këta nuk janë duke guxuar që t'i heqin këta billborda sepse sigurisht është dikush i fortë aty e nuk është zbatuar as vendimi i Kuvendit për largimin e billbordave. Këtu shihet që këta nuk kanë vendimmarrje dhe s'kanë nivel. Çka është në pyetje me ju?! Drejtor, hiqi billbordat dhe respektoje vendimin e Kuvendit dhe mos na detyroni që të shkojmë me procedura ligjore.

Kërkesa e jonë është që së pari të hiqen billbordat dhe që sot të marrim vendim për të dhënë pronën në shfrytëzim për reklamat në katër hyrjet e qytetit.

Arbëreshë Krasniqi: Ne si Kuvend e kemi marrur një vendim për këtë çështje dhe do të doja që Komisioni t'i jep edhe pak kohë vetës dhe të zbatohet ai vendim dhe komisioni të jetë më konstruktiv. Është mirë që ta presim Bashkimin deri sa të vijë dhe e keni mbështetjenë tonë ashtu siç e keni pasur.

Bashkim Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Ne e kemi shqyrtuar vendimin e Kuvendit por për Komisioni ka qenë e paqartë se ku do të vendosen këto reklama sepse sipas ligjit komuna e jep në shfrytëzim tokën jo billbordat që janë në hapësirë kështu që këto 288m² që është sipërfaqja e billbordave. Për këtë kemi kërkuar sqarime se në sa vende ndahe kjo sipërfaqe, çmimin për m² duhet që të sqarohet për metër të sipërfaqes së tokës e jo të billbordit dhe në këtë kuptim i kemi parqitur pikat tona që të sqarohen në vendim e radhës ose në ndryshim vendimin që do t'i bëhet që të jetë më i qartë dhe të zbatohet ashtu siç duhet.

Rrahim Morina: Drejtor, ju përmes drejtorive është dashur ta gjeni që ta saktësojmë më mire se sa sipërfaqe të tokës do ta lëshojmë sepse 288m² është tepër a mund ta lëmë 100m² sipërfaqen e tokës apo siç e vendosni ju. Ne duhet ta anulojmë vendimin e mëparshëm.

Nebih Bibaj: Ne sot nuk besoj që mund ta përfundojmë mbledhjen pa vazhdimë e ne si Komision është mirë që para të Hënës të mbajmë një takim me shefat e grupeve politike e që të vijmë me një vendim në Kuvend.

Rrahim Morina: A po pajtoheni me propozimin e Nebihut që kjo pikë të shtyhet në vazhdim të mbledhjes por bënë edhe për mbledhjen tjetër nëse kryhet kjo sot? Kush është pro këtij propozimi?

Për: 25 (unanimisht)

Me këtë votim aporovohet propozimi i Nebihut.

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës për Barazi Gjinore të parashtruar nga kryesuesja e Komitetit për Barazi Gjinore zj. Hidajete Mazreku. Këtë çështje e kemi diskutuar ka mbetur vetëm votimi. Atëherë kush është pro aprovimit të kësaj deklarate?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim miratohet edhe Deklarata për Barazi Gjinore e parashtruar nga znj. Hidajete Mazreku.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit vjetorë të punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale për vitin 2018. Fjalën e ka Nënkryetari.

Hajdin Berisha: Raporti i punës së Kryetarit dhe i qeverisë komunale në tërësi në afatin ligjor është paraqitur për shqyrtim.

Gjatë vitit 2018 qeveria komunale i ka kryer puntë konform kërkesave të qytetarëve të K. së Malishevës dhe planifikimeve për kryerjen e projekteve në tërësi. Prioritet i yni ishte në rritja e mirëqenies së qytetarëve dhe të gjitha investimet kanë qenë të përgatitura duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe të miratuara nga ana e Kuvendit. Viti 2018 konsideroj që ka qenë vit i suksesshëm bazuar në punën dhe në projektet e realizuara si dhe e kemi kaluar edhe në këtë vit luftën me suksese kundër Etheve Hemorragjike ku nuk kemi pasur asnjë rast të shënuar as me infeksion e as me vdekje.

Për të arritur këtu ku jemi drejtoritë përkatëse kanë qenë të angazhuara maskimalisht në fushat e tyre të përgjegjësisë. Ndërtimi i rrugëve, kanalizimi, ndërtimi i ujësjellësëve, ndërtimi i shkollave, investimet në bujqësi ka qenë fokusi kryesor në përmbushjen e nevojave e investimeve të drejtëpërdrejta.

Gjatë këtij viti kemi ndërtuar 27.3 km kanalizime, 33,3km rrugë, 39 sera, janë ndërtuar 13 shtëpi së bashku me donatorë, ndërtimi i objekteve të reja shkollore ku 3 nga to janë lëshuar për mësim. Investimet kapitale janë realizuar 97.8% nga 4.5 mil€ që kanë qenë të planifikuara. Në pika të shkurtëra e paraqita raportin e punës së Kryetarit për vitin 2018 dhe së bashku me drejtorët jemi në gjendje t'u përgjigjemi në pyetjet dhe shqetësimet e juaja.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: E falemnderoj Kryetarin e Komunës për raportin voluminoz me gjithë punët dhe angazhimet që i ka bërë për vitin 2018! Raporti është gjithëpërfshirës për të gjitha puntë dhe detyrat e drejtorive pa lënë anash asnjë punë që është kryer.

Kërkoj nga Kryetari që herave tjera më të ngushtë dhe të specifikohen vetëm pikat të cilat janë të intersuar asambleistët sepse disa pjesë të këtij raporti i kemi parë në raportet e drejtorive që është raportuar këtu.

Ne e çmojmë punën e Kryetari dhe e përgëzojmë që gjithëmonë është i gatshëm për takime me qytetarët qoftë përmes debateve publike qoftë në takime në zyren e tij.

Alban Mazreku: Në raport kam hasur që Zyres së Kryetarit 521 kërkesa, por nuk ceket se sa prej këtyre kërkesave kanë marrur përgjigje.

Shetësuese mbetet fakti edhe pse ne si grup e kemi ngritur çështjen e kontratave mbi vepër përsëri edhe në vitin 2018 i ke të punësuar 65 persona me kontratë mbi veprën, Nënkryetar. A po respektohen procedurat për punësimin e njerëzve me kontratë mbi veprën? Një rast siç është i punësuar Amrush Elshani në Drejtorinë për Kulturë me kontratë mbi vepër dhe i njëti thirret edhe si ekspertë i jashtëm për velërësimin e ndarjeve të subvencioneve nga kjo drejtori. Kjo është puro e konfliktit të interesit dhe këtë lëndë do ta dërgojmë në Atikorrupcion.

Çështjen e ndriçimit publik shpeshherë e kam ngritur këtu edhe pse keni intervenuar përsëri kemi probleme edhe pse sipas jush janë ndarë 70-80 mijë€.

Te investimet kapitale ndryshon raporti i Drejtorisë së Financave me raportin e Kryetarit. Pra gjërat që janë përfshirë në atë raport nuk janë përfshirë këtu siç janë: rregullimi i minitransitit në lagjen "Veselaj" në drejtim të fshatit Banjë, Rregullimi i shtratit të lumit "Mirusha" prej Urës së Madhe në drejtim të "Urës së Tranzitit", investimi në kanalizimin e rrugës "Mulla Selimi" në fshatin Marali ku qetash ka filluar të punohet etj. Pra ju jeni duke manipuluar qytetarët dhe neve si Asamble po na vëni para aktit të kryer e që ne jemi të detyruar të ndjekim rrugët ligjore.

Arbëreshë Krasniqi: Ne si grup e kemi diskutuar gjatë këtij raport dhe ndjehemi mirë me punët të cilat janë realizuar dhe po realizohen në K. e Malishevës. Ne kemi dhënë vërtetje në mbikëqyrje sa më të madhe në të gjitha projektet që po realizohen dhe do të realizohen në të ardhmen.

Alban, K. e Malishevës po prinë me rregullimin e infrastrukturës në nivel të komunave të Kosovës dhe po ineqsoteket në të gjitha fshatrat.

Sa i përketë përkrahjes së OJQ është hera e parë që Drejtoria e Kulturës e Rinisë dhe Sportit ka përkrahur mbi 80% të OJQ dhe kjo drejtori është një ndër më të sukseshmet në K. e Malishevës.

Raimonda Krasniqi: Nuk e përmenda Drejtorinë e Kulturës, por përmenda konfliktin e interesit që kanë sjellë përfitimin e OJQ me të cilën është bashkëpjesëmarrëse vetë e nderuara drejtoreshë e Kulturës.

Në dokumentet e juaja rezultojnë 4 shkolla që janë ndërtuar gjatë qeverisjes së NISMA ndërsa 14 shkolla rezultojnë që janë ndërtuar gjatë qeverisjes Kilaj.

Hajdin Berisha: Nëse flitet për subvencionimin e OJQ për vitin 2018, ndërsa çështja e cila u ngrit jashtë rendit të ditës i përketë vitit 2019.

Ali Morina: Nuk e di që në raportin që e ka sjellë Kryetari nuk e ka shqetësuar fakti i lëndëve në padi. Në lëndë përmbartimore janë 10, 5 nga ato janë të aprovuara dhe përveç shumës që komuna është dashur të paguaj si obligim ka paguar edhe shumën shtesë për përmbartues privat. Krejt këto janë paguar me taksa të qytetarëve.

Shqetësuese është edhe largimi i të punësuarëve ku 6 nga ta janë larguar nga puna në vitin 2018, ndërsa nga ta janë khyer 4, 1 është në procedura të gjykatës dhe 1 prej tyre ka marrur përgjigje negative. Pra Arbëreshën nuk e shqetësoi ky fakt por bëhet avokate e ekzekutivit, e as nuk e shqetësoi devijimi i projekteve në shumë prej 1 milë.

Nënkryetar, te Drejtoria e Inspektoriatit ka një mospërputhje në mes të raportit të shpenzimit i cili është 00, ndërsa në këtë raport që keni sjell sot prej të hyrave të gjobave 1,854€. Ndërsa po në për këtë drejtori thuhet që janë trajtuar të gjitha ankesat. Drejtor, te ankesat konkrete në kyçjen e shtëpive në rrjetin e kanalizimit. Sa prej tyre ankesave dhe kërkesave janë zgjidhur dhe sa familje janë kyçur në rrjetin e kanalizimit?

Në raport thuhet që shumë prej deponive të mbeturinave inerte janë larguar dhe aksioni "Ta pastrojmë Kosovën" nuk është përkrahur vetëm nga komuna por edhe nga qytetarët nga rinia e PDK-së etj. Në raportin "Ta pastrojmë Kosovën" thuhet që janë larguar 3 deponi. Tash sa janë shumë për ju?

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Ky raport është shumë voluminoz dhe disa gjëra statistikore nuk janë shprehur e që për ne janë të rëndësishme e ku shumica janë të cekura si të kryera por krahasuar me të hyrat e vitit 2018 janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Për këtë arsye në hartimin e raportit në të ardhmen gjërat të jenë më të specifikuara që ne ta kemi të qartë se çka ka bërë Kryetari.

Duke u nisur nga ky raport në përmbushjen e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve por nuk janë të specifikuar se cilat kërkesa janë përmbush e cilat ankesa janë refuzuar.

Sa i përketë sektorit të arsimit 16 punëtorë janë marr jashtë konkursit e ende nuk është dhënë asnjë shpjegim për këtë dhe kanë qenë duke punuar pa paga.

Në raportin e Kryetarit te shëndetësia thuhet që kemi specialistë, internistë atëherë pse nuk kryhen të gjitha vizitat e në gjinekologji të mos kryhet Papa-testi? Ndërsa sa i përketë Pediatrisë a mundet 1 pediatër t'i kryej të gjitha kontrollet e famijëve që kërkojnë shërim?

Ndërsa sa i përketë projektit me Handikosin aty Kryetari i ka punësuar të gjithë militantët e vetë dhe si shkojnë puët aty nuk e di.

Te investimet kapitale, te ndërtimi i kanalizimeve, trotuarëve, i rrugëve këtu thuhet që janë kryer ndërsa në realitet ato punë nuk janë kryer.

Rrahim Morina: Mbase ka edhe diskutues të tjerë shkojmë në pauzën e drekës dhe kthehemi në mbledhje në ora 13:15.

Pas pushimit vazhdojmë me debatin për pikën e 9-të të rendit të ditës.

Kastriot Berisha: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Unë si asambleisti më i votuar i PDK-së nga meshkujt dhe Florentina Zulfaj më e votuara nga femrat sot zyrtarisht të njoftojmë Kryesues që ne kalojmë të pavarur. Arsyen të gjithë do ta kuptojnë me shkrim në rrejtet sociale.

Rrahim Morina: Ky është përcaktimi dhe vullneti i juaji dhe ne u urojmë punë të barë kudo që jeni! Vazhdojmë me debatin.

Sadije Krasniqi: Me të vertetë ky është një raport voluminoz ku shihet qartë qëllimi i qeverisjes Begaj rritja e mirëqenies sociale përmes investimeve të projekteve në krijimin e kushteve për punë për gjithë mbrenda mundësive buxhetore të komunës. Në listën e investimeve më së shumti është munduar që të investojë në fushën e bujqësisë në mënyrë që të krijohen kushtet më të mira për banorët e Malishevës.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Sa i përketë këtij raporti ne kemi shpresuar që t'na sjellë disa sqarime të cilat na kanë munguar në raportin e Drejtorisë së Finacave. Ne për këtë ju kemi drejtuar me shkrim si KPF dhe në asnjërën nga kërkesat që ju kemi drejtuar ekzekutivit nuk na janë përgjigjur.

E them me keqardhje që ky raport nuk i përmbush kriteret e raportit dhe është si lloj romani se sa raport. Sa i përketë punimev që janë duke u monitoruar she atyre që e bëjnë pranimin teknik kjo është për keqardhje sepse unë kam kërkuar që të ndërpriten punimet e kanalizimit në Marali sepse nuk ajnë duke u respektuar paramasat dhe parallogaritë që janë në tender. Pavarsisht premtimeve që ka barë drejtori aty nuk është punuar ashtu siç duhet. Personalisht këtë rast do ta dërgoj në proukrori. Asnjë investim kapital nuk është i kryer sipas paramasave dhe parallogarive. Siquerisht me vjen keq se në çfarë niveli ka ardhur qeverisja Begaj!

Hajdin Berisha: Kastriotit dhe Florentinës ju uroj suksese kudo që të jenë mbrenda Asamblesë. Sipas shumicës së diskutimeve raporti dominojë që është voluminoz dhe i ngarkuar me statistika por duhet ta keni parasysh edhe faktin që edhe punët kanë qenë voluminoze. Të gjitha vërjetjet dhe sygjermiet e juaja do t'i marrim parasysh në hartimin e raporteve tjera. Jam që të ketë mbikëqyrje më të rreptë të projekteve në mënyrë që operatorët të cilët nuk i kryejnë punët siç duhet duhet të ketë penalizime ndaj tyre sepse është paraja publike. Profesoresha diskutoi për shëndetësinë por sa i përketë profileve në QKMF aktualisht janë 2 pediatër, ka gjinekologë, specialistë të internos dhe përmes bashkëpunimit me HEANDKOS-in është rritur numri i kujdesjes mjeksore. Në vitin 2014-2015 në kohën kur kam qenë drejtor kemi

bërë përpjekje që të ndryshojmë një udhëzim administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë që kufizon profesionet të cilat mund të punojnë në QKMF.
Këtu nuk u përmend që në vitin e kaluar të gjithë studentët që kanë aplikuar kanë marrur bursa ndërsa edhe në këtë vit jemi në fazën për ndarjen e bursave. Falemnderit të gjithëve!

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2019. Drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Po e paraqes në pika të shkurtëra raportin e 3-mujorit të parë për periudhën Janar-Mars të vitit 2019. Ky raport është i përpiluar në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe në bazë të standardeve ndërkombtare të kontabilitetit dhe procedurave të thesarit për të hyrat dhe shpenzimet të cilat kanë ndodhur mbrenda kësaj periudhe.

Në bazë të dhënave të prezantuara në tabletat përkatëse në këtë raport rezulton se Komuna e Malishevës ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2019 me shumën 14,392,379.89€ për të gjitha programet dhe nënprogramet.

Buxheti i alokuar për këtë periudhë kap vlerën 6,326,895.65€ që d.m.th që shkalla e realizimit të buxhetit në total është 43.96%. Sipas shënimeve të librave të thesarit del që shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për këtë periudhë është 2,867,478.85€, pra 45%. Pra fjala është për buxhetin e realizuar, jo të totalit të buxhetit.

Në faqet në vazhdim janë dhënë tabelat e planit të buxhetit realizimi, shpenzimi sipas programeve, sipas burimeve, sipas kategorive ekonomike në mënyrë sintetike dhe analitike për periudhën Janar- Mars 2019.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Sylë Dukolli: Sa i përketë këtij raporti të 3-mujorit të parë të të hyrat nga tatimi në pronë ende nuk janë shpërdarë dërgesat se do të ishin rritë të hyrat. Drejtor, të përgezohet për këtë raport sepse është ndër më të mirët që kemi marrur nga drejtoria e juaj dhe e keni paraqitur në statistika reale edhe të hyrat edhe shpenzimet.

Sa i përketë realizimit të projekteve kërkoj edhe njëherë që në mbikëqyrjen e projekteve të jeni më syqelë dhe në komisione dërgoni inxhinierë dhe njerëz profesional që i përcjellin punimet e projekteve.

Rrahim Morina: Po e ju informoj që KDI nesër në ora 10 organizon një puntori dhe ju lus që të merrni pjesë me nga një përfaqësues ju kam përcjell këtë njoftim edhe me e-mail.

Sadije Krasniqi: Konsideroj që ky raport është dukshëm më i avancuar se sa herave tjera në kuptimin e përshkrimit të të dhënave përmes grafikoneve. Kërkoj që edhe përmbledhja e të

hyrave komunale sipas burimeve të jetë me grafikone gjithashtu edhe shpenzimet e buxhetit sipas programeve buxhetore të jetë në formë të grafikoneve.

Për periudhën 3-mujore ka pasur të hyra vetanake prej 251,447,06€ dhe krahasuar me vitin paraprak kemi pasur rreth 178,498,00€ ka pasur rritje të të hyrave vetanake.

Kërkoj që mbrenda mundësive të zvogëlohen shpenzimet te mallërat dhe shërbimet, te shpenzimet komunale dhe orientimi i buxhetit gjithëmonë le të jetë nga investimet kapitale dhe subvencionet.

Hashim Vrenezi: Shqetësuese për mua në këtë raport janë shpenzimet kontraktuese tjera pse kanë shkuar çdo vit në rritje? Kjo rritje për një 3-mujor është mbi 30,000€ e që i bie që deri në fund të vitit do ta kalosh shumën e 120,000€ në raport me rritjen me raportin paraprak. Gjithashtu në rritje është edhe kategoria e mallërave dhe shërbimeve.

Shqetësues janë edhe vendimet e gjykatave që është në rritje dhe për këtë periudhë rritja është për 8,289€ në raport me vitin e kaluar.

Te tabela 7.5 për shpenzimet kapitale, te transferet kapitale indetitetit jopublik. Dua sqarime se çka përfshihet mbrenda këtij zëri buxhetor?

Hidajete Mazreku: Sa i përketë këtij raporti kësaj rradhe janë marrur disa sugjerime dhe vërejtje tona për hartimin e raportit dhe janë specifikuar disa gjëra.

Sa i përketë mallërave dhe shërbimeve kam një vërejtje për Zyrën për Komunitet ku 883€, por unë nuk e di se për çka është shpenzuar kjo shumë. Për çfarë është ky shpenzim?

Te subvencionet dh transferet janë 45,000€ por është dashur që të specifikohen se për çfarë bëhet fjalë? Te shërbimet kontraktuese tjera cialt janë këto shërbime dhe pse rriten në raport me vitin e kaluar? Te pagat, përfaqësuesit individual, kush është ai që i përfitoi 6,300€?

Regjistrimi i ndriçimit publik janë 68,000€ cilat janë këto regjistrime sepse Kryesuesi ka thënë veç për rrugët kryesore sepse edhe për lagjën time është bërë regjistrimi por ne nuk kemi ndriçim publik.

Rregullimi i parkut të qytetit është 15,000€ çka është rregulluar aty? Te investimet kapitale është edhe shëndetësia primare, çka keni investuar aty? Këto janë para të qytetarëve dhe dua të di se ku do të investohen ato.

Valon Mazreku: Sylë, te alokimi i investimeve kapitale sipas planit kontabël kemi kërkuar që investimet kapitale të alokohen në 3-mujorin e parë me qëllim të inicimit të procedurave të prokurimit.

Sadije, kërkoje një ulje të shpenzimeve për mallëra dhe shërbime dhe për komunalitë dhe këto mjete dhe nga kjo të përfitojnë subvencionet dhe investimet kapitale.

Hashim, te vendimet e gjykatës shumica e tyre janë për Drejtorinë e Arsimit përkatësisht për 3 pagat shtesë dhe ato 3 jubilarë.

Transferet kapitale për indetitete jopublike kryesisht janë investimet në bujqësi sepse nuk mund të trajtohen si pronë e komunës dhe nuk ajnë për përdorim publik të komunës por për përfitues të subevcionve.

Në shërbime kontratuese tjera bëjnë pjesë disa kontrata për shërbime të veçanta, kontratat e mirëmbajtjeve të objekteve, marrëveshjet me misnistri pra janë disa shërbime që nuk kanë kod ekonomik e ne i emërtojmë si shërbime tjera kontraktuese. Nëse doni ën mënyrë të hollësishme mund ta nxjerrim listën nga sistemi.

Profesoreshë, shpenzimet e Zyrës së Komunitetit e ka bërë drejtorja përkatse dhe mund ta shikojmë në sistem se çka është bërë saktësisht. Ndriçimi publik çdo vit po rregullohet dhe shumë çdo herë po shtohen shtyllat ndriçuese në K. e Malishevës.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtim i Raportit të detajuar të punës së zyrës së Tatimit në pronë për vitin 2018. E hapi debatin. Mbase s'ka debatues e hudhi në votim. Kush është pro miratimit të raportit të detajuar të punës së Zyrësë Tatimit në Pronë për vitin 2018?

Për: unanimsisht

Kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndërtim të shtëpive për familjet e pa strehë. Shkojmë me propozime për anëtar të këtij komisioni ku secili subjekt e ka nga një anëtar për këtë komision. Mirë NISMA s'ka të propozuar për këtë mbledhje.

Alban MazrAeku: Ne grupi ynë e propozojmë anëtar të këtij komisioni Ali Morinën.

Valon Krasniqi: LDK-ja propozon Rrahim Morinën si anëtar të këtij komisioni.

Hidajete Mazreku: Ne VV-ja propozojmë Alban Krasniqin.

Rrahim Morina: NISMA dhe Zyra e Kryetarit nuk kanë propozime. Atëherë shkojmë në votim për këto 3 propozime. Kush është për që Ali Morina, Rrahim Morina dhe Alban Krasniqi të jenë anëtarë të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndërtimin e shtëpve për familjet e pastreha?

Për: 13

Kundër: 0

Abstenim: 8

Me këtë votim zgjidhen anëtarët e këtij komisioni.

Kalojmë në pikën e 13-të të rendit të ditës: Emërimi i anëtarëve të Komisionit për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve. Përsëri është e njëta procedurë ku kërkohet plotësimi me nga 1 anëtar të subjekteve politike dhe një nga Zyra e Kryetarit. Shkojmë me propozime.

Alban Mazreku: Ne propozojmë Nebih Bibaj anëtar të këtij Komisioni.

Arind Morina: LDK-ja propozon Valon Krasniqin.

Ilaz Krasniqi: Ne VV-ja propozojmë Veton Zogaj.

Rrahim Morina: NISMA dhe Zyra e Kryetarit nuk kanë propozime. Ne shkojmë në votim për emrat e propozuar Nebih Bibaj, Valon Krasniqi dhe Veton Zogaj që të jenë anëtar të Komisionit për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve. Kush është për?

Për: 13

Kundër: 4

Abstenim: 4

Me këtë votim formohet Komisioni për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve.

Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/192 datë:22.03.2019 të parashtruar nga Kryetari i fshatit Novosellë. Ata kanë kërkuar që të ndahet zona kadastrale e fshatit Novosellë si zonë e veçantë. Kërkesa e KPF-së ka qenë që të sillen nënshkrimet, materialin e keni marrë, nënshkrimet janë. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër ka kërkuar sqarime shtesë dhe Agjensioni Kadastral ia ka kthyer përgjigjen dhe thotë që Kuvendi ka të drejtë që të nxjerrë një rekomandim që pastaj të procedohet për Agjensioni Kadastral të Kosovës. Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim:0

Me votim unanimit aprovohet kërkesa e fshatit Novosellë.

Kalojmë në pikën e 15-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/88 datë:07.02.2019 për ndarjen e zyrave për ushtrimin e punëve dhe aktiviteteve për Shoqatën e Kryqit të Kuq të Kosovës-Dega në Malishevë dhe Shoqatën e Pensionistëve në Komunën e Malishevës, nr.02/88 datë:07.02.2019 sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-146/3 datë: 06.03.2019, si dhe marrja e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës publike. Këtë pikë e kemi debatuar dhe kemi biseduar me Kryetarin dhe kemi ardhur në përfundim që vendimi i mëhershëm duhet të anulohet sepse ka ndryshime. Njëherë e anulojmë këtë vendim e pastaj e autorizojmë Kryetarin që të lidh marrëveshje për shfrytëzimin e këtyre dy hapësirave edhe me Kryqin e Kuq edhe me shoqiatën e arsimtarëve pensionistë. Atëherë kush është pro shfuqizimit të vendimit nr.02/88 datë:07.02.2019?

Për: 12

Kundër: 0

Abstenim: 8

Atëherë e autorizojmë Kryetarin që të lidh marrëveshje për shfrytëzimin e këtyre dy hapësirave edhe me Kryqin e Kuq edhe me shoqiatën e arsimtarëve pensionistë. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 5

Pikat e rendit të ditës kanë të bëjnë me ndërrim destinim: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/29 datë:15.03.2019 të parashtruar nga z.Mujedin Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/27 datë:18.03.2019 të parashtruar nga z.Hazir Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/28 datë:18.03.2019 të parashtruar nga z.Alban Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/33 datë:21.03.2019 të parashtruar nga z.Qamil Vesel Hoti nga fshati Carrallukë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.


Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/38 datë:27.03.2019 të parashtruar nga z.Bahti Thaçi nga fshati Mirushë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Atëherë i votojmë në pako. Kush është për?

Për: unanimsisht

Për këto pika të rendit të ditës vendimin e nxjerrim një për një për secilën veç e veç. Falemnderit për pjesëmarrje dhe me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 15: 00

Procesmbajtësja: Samir Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit: Bراهيم Morina

